KËRKESË
Nr. 190/12, datë 28.4.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i Urës së fshatit Metoq'", Bashkia Sarandë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Sarandë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "arë", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 49,256 (dyzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

Nr.	PRONARI				TË DHËNA KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË							Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Adresa e pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (m²)		
1	Ibrahim Çuni			Metoq	2677	101/115	Arë	1788	524.0	94	49,256	49,256	
2	Shtet			Metoq	2677	1190	Arë		525.4	0	0		
TOTALI												**49,256**	